



Komuna e Podujevës



## Projekt – Propozim

**“Ngritja e kapaciteteve profesionale të të rinjëve dhe bizneseve aktive për zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive për ndërmarrësi dhe biznes plane, si dhe dhurimin e granteve për biznese në Komunën e Podujevës”**

Podujevë,  
Gusht 2021

|  |          |
|--|----------|
| <b>I. HYRJE .....</b>                                  | <b>3</b> |
| <b>II. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT .....</b>                | <b>4</b> |
| 2.1. OBJEKTIVAT E PROJEKTIT .....                      | 4        |
| 2.2. METODOLOGJIA E IMPLEMENTIMIT .....                | 5        |
| 2.3. KOSTOJA E PROJEKTIT .....                         | 7        |
| 2.4. KOHËZGJATJA E PROJEKTIT .....                     | 7        |
| <b>III. ANEKS .....</b>                                | <b>8</b> |
| 3.1. BUXHETI I PLANIFIKUAR .....                       | 8        |
| 3.2. PROFILI I BSCK-SË .....                           | 8        |
| 3.3. MODELI I MOU'SË (BSCK – KOMUNA E PODUJEVËS) ..... | 8        |

## I. Hyrje

Në vitin 2019 një virus i ri i quajtur (COVID-19) ka shkaktuar një pandemi botërore me pasoja të mëdha për njerëzimin. Si e tillë kjo pandemi ka krijuar shumë ç'rregullime në jetën e njerëzve duke ndikuar në ndalimin dhe kufizimin e lëvizjeve, ç'rregullimin e tregjeve financiare, problemet në zingjirinë e furnizimit. Pandemia ka ndikuar më shumë në aktivitetin biznesor në të gjithë sektorët. Në Kosovë sikurse edhe në shumë vende të botës bizneset janë duke vuajtur nga ndikimi i madh që ka shkaktuar pandemia si rezultat i virusit COVID-19. Pjesa më e madhe e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) tanimë janë prekur nga koronavirusi në shumicën e vendeve të botës, përfshirë edhe Kosovën përkatësisht komunën e Podujevës.

Pandemia e COVID-19 ka çuar në marrjen e masave të rrepta nga institucionet e Kosovës për të parandaluar përhapjen e virusit. Disa nga masat përfshijnë mbylljen e të gjitha institucioneve arsimore publike dhe private, mbylljen graduale fizike të të gjitha ndërmarrjeve që merren me tregti me pakicë, të industrisë së ushqimit dhe shërbimeve, anulimin e të gjitha fluturimeve dhe mbylljen e të gjithë kufijve tokësorë. Karantinimi i njerëzve në shkallë të gjerë, kufizimet e udhëtimit dhe masat për distancimin shoqëror dhe masat tjera restriktive për mbylljen e bizneseve shkaktojnë një rënie të ndjeshme të shpenzimeve të konsumatorit dhe biznesit. Masa e fundit e ndërmarrë është kufizimi i lëvizjes së qytetarëve dhe makinave private brenda afateve kohore specifike. Kjo për arsye, se konsumatorët qëndrojnë në shtëpi, bizneset humbasin të ardhurat dhe pushojnë punëtorët dhe nivelet e papunësisë rriten ndjeshëm. Për pasojë, bizneset heqin dorë nga investimet dhe falimentimet e kompanive rriten, duke bërë presion të ndjeshëm në sistemin bankar dhe financiar.

Prandaj, nevojitet një intervenim i qeverisë me një arsenal masash për të përkrahur bizneset për të tejkaluar krizën nga pandemia. Kriza pritet të ketë ndikime të mëdha sociale dhe ekonomike, pasi industria e shërbimeve dhe tregtia janë goditur ndjeshëm. Institucionet qendrore kanë ndërmarrë masa për të mbështetur bizneset përfshirë propozimin e një pakije të stimulimit fiskal për të mbështetur rimëkëmbjen e sektorëve privat dhe publik nga kriza. Ndërsa kriza shpërndahet dhe varësisht nga kohëzgjatja e saj, implikimet sociale dhe ekonomike do të jenë domethënëse. Ndikimi do të varet nga rritja e papunësisë, varfëria e thelluar, humbja e të ardhurave, pasiguria e vendeve të punës, pabarazitë specifike të industrive, deri te ngecja në arsim e ngecja në përpjekjet për të zvogëluar hendekun gjinor në Kosovë. Sfidat do të jenë veçanërisht të rënda për familjet në nevojë, të cilët jetojnë me burime të ardhurash të përditshme.

Projekti **“Ngritja e kapaciteteve profesionale të të rinjëve dhe bizneseve aktive për zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive për ndërmarrësi dhe biznes plane, si dhe dhurimin e granteve për biznese në Komunën e Podujevës”** do të ndikojë në fuqizimin e bizneseve aktive dhe krijimit të bizneseve të reja duke krijuar vende të reja të punës dhe është e domosdoshme dhe nevojë jetike të implementohen projekte të tilla në veqanti aktualisht që jemi duke bashkëjetuar me virusin COVID-19 i cili është duke krijuar probleme të mëdha në jetën sociale dhe ekonomike.

## II. Përshkrimi i projektit

Projekti “Ngritja e kapaciteteve profesionale të të rinjëve dhe bizneseve aktive për zhvillimin e aftësive dhe shkathhtësive për ndërmarrësi dhe biznes plane, si dhe dhurimin e granteve për biznese në Komunën e Podujevës” i cili planifikohet të implementohet në komunën e Podujevës është ndihmesë e madhe për bizneset fillesatare dhe të rinjët të cilët planifikojnë të hapin biznese të reja. Projekti është unik dhe i dedikohet të rinjëve ndërmarrës dhe bizneseve fillestare. Qëllimi kryesor i projektit është që të ndihmojë në ndërtimin dhe zhvillimin e ekosistemit të ndërmarrësisë në komunën e Podujevës mbi parime profesionale dhe t’i përgatisë të rinjët ndërmarrësdhe të diplomuarit për punësim dhe vetëpunësim si dhe të kontribuojë në zhvillimin e ndërmarrjeve të reja inovative që e ndihmojnë zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e mirëqenies në vend, gjithashtu do të bëjë ngritjet e kapaciteteve profesionale të të rinjëve që të sigurojnë një përmirësim të dukshëm për krijimtari dhe inovacion në vendin e punës dhe gjithashtu një forcë punëtore që është shumë e përshtatshme dhe e aftë për të përmbushur sdat e së ardhmes dhe nevojat e ndërmarrjeve.

Ndërsa pas trajnimeve do të dhurohen grante nga Komuna e Podujevës e cila do të jetë ndihmesë e madhe dhe do të ndikojë pozitivisht në themelimin e bizneseve të reja duke gjeneruar vende të reja të punës përmes vetë-punësimit si dhe fuqizimin e bizneseve fillestare përmes ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe mbështetjes me pajisje.

### 2.1. Objektivat e projektit

Projekti ka për objektiv kryesor ofrimin e shërbimeve për zhvillimin e shkathhtësive të buta për 50 të rinjë

Në mënyrë specifike ky projekt ka për objektiv:

- Zhvillimi i trajnimit për 50 pjesëmarrës. Trajnim në këto module: *a) Ndermarresi dhe shkathtesi biznesi, b). Plani i Biznesit, c) Menaxhimi bazik i Financave dhe Kontabilitetit, d) Digjital Marketing, e). Media Sociale, dhe f) Menaxhimi i Shitjes dhe Logjistikes.*
- Zhvillimi i ideve nëpërmjet përvojave të bartura dhe të prezantuara, si nga ana e trajnerëve po ashtu edhe nga pjesëmarrësit.
- Përmirësimi i mundësive ekonomike për të rinjët duke ofruar qasje të qëndrueshme në shërbimet e të rinjëve në Podujevë;
- Ngritjet e kapaciteteve profesionale të të rinjëve që të sigurojnë një përmirësim të dukshëm për krijimtari dhe inovacion në vendin e punës dhe gjithashtu një forcë punëtore që është shumë e përshtatshme dhe e aftë për të përmbushur sfidat e së ardhmes dhe nevojat e ndërmarrjeve.

- Po ashtu, projekti do të kontribuojë në vetëdijësimin e të rinjëve për shfrytëzimin dhe valorizimin e teknologjisë së informacionit. që për një kohë të shkurtë të qëndrueshëm dhe të krijojnë të hyra përmes aktiviteteve të veta biznesore ose kontrata të punës për marketing digjital me punëdhënës,
- Përmes subvencionimit arrihet fuqizimi ekonomik i të rinjve, grave dhe grupeve të marginalizuara të shoqërisë, për të garantuar zhvillim ekonomik dhe social për të gjitha kategoritë shoqërore;
- Subvencionimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në komunën e Podujevës ndikon në rritjen e kapaciteteve konkurruese dhe në efikasitet; dhe njëkohësisht i ndihmon në tejkalimin e situatës së krijuar nga COVID-19 përmes digjitalizimit apo ngritjes së kapaciteteve me pajisje të nevojshme;
- Gjithashtu subvencionimi i ideve të reja dhe kreative për themelimin e bizneseve të reja i kontribuonë vetë-punësimin në komunën e Podujevës;
- Të përkrahën projekte që kanë për qëllim aftësimin profesional për ngritjen e aftësive të fuqisë punëtore dhe kompetencës profesionale; dhe
- Të përkrahën programet e trajnimeve dhe konsulencës vendore dhe ndërkombëtare për rritje të kapaciteteve, analiza ekonomike;

## 2.2. Metodologjia e implementimit

Për të arritur këto objektiva, ky projekt është zhvilluar dhe dizajnuar të realizohet në disa etapa, duke ofruar këto aktivitete:

1. Fushata për ngritjen e vetëdijes për ndërmarrësi dhe për promovimin e ideve të reja – Gjatë fushatës një mujore do të informohen dhe do të inkurojohen të gjithë qytetarët e Podujevës, si dhe grupet e marginalizuara, që të jenë pjesëmarrës aktiv në këtë projekt, duke ju ofruar të dhëna të mjaftueshme rreth përfitimeve dhe dobive nga ky projekt, sidomos subvencionimin e idetve të reja ndërmarrëse. Fushata do të orientohet në organizimin e eventeve sidomos në pjesët rurale, pasi që në këto pjesë informimi dhe inkurajimi i të rinjëve për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e tyre është i vogël. Poashtu përmes mjeteve të informimit dhe përmes portaleve do të tentohet të bëhet informimi sa më i madhë për këtë projekt.
2. Identifikimi dhe inkurajimi i ndërmarrësve të rinjë dhe ideve të reja inovative për pjesëmarrje në projekt – Pas procesit të fushatës dhe promovimit të projektit, do të bëhen shpalljet për të gjithë të interesuarit për trajnime dhe ngritje të kapaciteteve në ndërmarrësi dhe ide inovative. Përzgjedhja e kandidatëve më të mirë do të bëhet përmes përcaktimit të kritereve të qarta dhe përmes një procesi transparent, ku përparësi do të kenë përfaqësuesit e gjinisë femërore, dhe pjestarët e grupeve të marginalizuara, por gjithmonë duke mos cenuar barazinë dhe transparencën e këtij procesi. Ngritja e kapaciteteve dhe fuqizimi i tyre përmes organizimit të trajnimeve për ndërmarrësi për të gjitha idetë inovative dhe për ndërmarrësit e rinjë.

3. Gjatë këtyre trajnimeve do të bëhet ngritja e kapaciteteve të pjesëmarrësve në ndërmarrësi, në mënyrë që të jenë të aftë të menaxhojnë më bizneset e tyre në një të ardhme të afërt. 50 pjesëmarrësit do të jenë të aftë që të: përgatitin planet e tyre të biznesit, të menaxhojnë me burimet financiare dhe kontabilitet, të bëjnë promovimin dhe marketingut e produkteve dhe shërbimeve të tyre, si dhe të përvetësojnë aftësitë negociuese. Trajnimet për ndërmarrësi do të organizohen në këto module: *Ndërmarrësi dhe shakthësi biznesi, b). Plani i Biznesit, c) Menaxhimi bazik i Financave dhe Kontabilitetit, d) Digjital Marketingu, e). Media Sociale, dhe f) Menaxhimi i Shitjes dhe Logjistikës.*
4. Po ashtu rëndësi e veçantë përgjatë trajnimeve do t'ju kushtohet edhe këtyre tematikave shumë të rëndësishme:
  - a. **Puna në grup** – është një aftësi e butë pa të cilën aftësi askush nuk mund të funksionojë këto ditë.
  - b. **Komunikimi efektiv** – është ndoshta më e lehta e aftësive të buta për të mësuar, si psh në internet, veçanërisht pasi njerëzit mund të përfitojnë thjesht nga dëgjimi ose shikimi i komunikuesëve të mirë dhe duke parë si e bëjnë këtë. Pra komunikimi nuk mbulon vetëm folejn por edhe dëgjimin si dhe duke mësuar se kur është e rëndësishme.
  - c. **Zgjidhja e problemeve** – nuk është thjesht analitike. Punonjësit duhet të mësojnë të trajtojnë problemet me qetësi të dinë se kur duhet marrin ndihmë (përsëri në punën e ekipit), kur të mbajnë barrën dhe kur të heqin dorë dhe të marrin një pushim ose të provojnë qasje tjetër.
  - d. **Menaxhimi i kohës** – mund të përfitojnë nga trajnimi në internet dhe përdorimi i mjeteve të produktivitetit për të inkurajuar fokusimin dhe prioritizimin e detyrave.
  - e. **Zgjidhja e konflikteve** – Kjo aftësi mund të mësohet duke përdorur skenarë, dhe lojëra të roleve.
5. Procesi i subvencionimit do të zhvillohet përmes përcaktimit të kriterëve të qarta dhe përmes një procesi transparent duke mbështetur ideve më të mira dhe kreative për themelimin e bizneseve të reja për subvencionim si dhe seleksionimin e bizneseve aktive fillestare në plotësimin e nevojave për fuqizimin e tyre;
6. Pas trajnimeve do të zhvillohet faza e mentorimit për përfituesit e subvencioneve që kanë ide për themelimin e ndërmarrjeve dhe atyre që janë në fazën fillestare të operimit të biznesit.
7. Përgatitja e video dokumentarit me aktivitetet e projektit - Përgjatë të gjitha aktiviteteve të projektit do të bëhen fotografi dhe videomateriale në mënyrë që në fund të mund të bëjmë një dokumentim të arritjeve dhe sukseseve të projektit, si dhe të dëshmojmë dhe të inkurajojmë rinjtë e tjerë të jenë më aktiv dhe të angazhohen në projekte të tilla zhvillimore me qëllimin e ngritjes së kapaciteteve të tyre dhe ngritjen e aftësive ndërmarrëse të tyre. Ky video dokumentar do të shërbejë edhe donatorit të bëjë më tutje edhe promovimin dhe vetëdijësimin e qytetarëve të Podujevës në rëndësinë e madhe që e

kan idetë inovative dhe idetë e reja ndërmarrëse, mënyra më e mirë me nxit punësimin dhe shtimin e vendeve të punës, por edhe njëherit rëndësia e të bërit biznes në vendin tonë. Ky dokumentar do të prezantohet në konferencën përmbyllëse, dhe do të bëhet promovimi i tij në televizionet tona si ato lokale edhe ato nacionale.

### 2.3. Kostoja e projektit

Kostoja totale për implementimin e projektit është 38,000.00 Euro dhe do të bëhet në bashkfinancim si në vijim:

1. Komuna e Podujevës do të alokoj mjete për implementimin e projektit në dhurimin e granteve për biznese në vlerë prej 29,311.00 Euro për grante në pajisje.
2. BSCK do të alokoj mjete financiare në vlerë prej 13,150.00 Euro për implementimin e projektit.

BSCK është e obliguar të destinoj kapacitetet e saj profesionale dhe teknike në planifikim dhe implementim të të gjithë projektit. Në bashkëpunim me Komunën e Podujevës do të jenë përgjegjës për mbikëqyrjen dhe implementimin e projektit në përgjithësi.

Në **ANEKS 1** është buxheti i detajuar për implementim të projektit.

### 2.4. Kohëzgjatja e projektit

Projekti do të implementohet në faza brenda periudhës tre mujore prej datës së nënshkrimit të Memorandumit të bashkëpunimit, si në vijim:

| Përshkrimi i aktivitetit   | Fillimi    | Përfundimi | Bartësit                  |
|--|------------|------------|---------------------------|
| <b>Përgatitja e materialeve për trajnime (Kurrikula)</b>   | 01.09.2021 | 15.09.2021 | Ekspertët e fushës        |
| <b>Sigurimi i hapësirave/sallave për trajnime</b>  | 01.09.2021 | 15.09.2021 | BSCK / Komuna e Podujevës |
| <b>Printimi i materialeve për pjesëmarrës</b>  | 01.09.2021 | 15.09.2021 | BSCK                      |
| <b>Përgatitja e aplikacionit online për aplikim për pjesëmarrje në trajnime</b>                            | 01.09.2021 | 05.09.2021 | BSCK                      |
| <b>Dizajnimi i banerave promovues</b>  | 01.09.2021 | 05.09.2021 | BSCK                      |
| <b>Promovimi i projektit dhe trajnimit (Rrjetre sociale, portale dhe media të ndryshme)</b>                | 01.09.2021 | 05.09.2021 | BSCK / Komuna e Podujevës |
| <b>Inicimi i procedurave të prokurimit/tenderuese për shpallje publike (blerja e pajisjeve për grante)</b> | 05.09.2021 | 15.09.2021 | Komuna e Podujevës        |
| <b>Përzgjedhja e operatorit ekonomik</b>   | 15.09.2021 | 20.09.2021 | Komuna e Podujevës        |
| <b>Përzgjedhja e pjesëmarrësve nga komuniteti i biznesit dhe të rinj ndërmarrës</b>                        | 15.09.2021 | 20.09.2021 | BSCK / Komuna e Podujevës |

|  |            |            |                          |
|--|------------|------------|--------------------------|
| <b>Implementimi i trajnimeve intenzive</b>   | 21.09.2021 | 30.09.2021 | BCK / Komuna e Podujevës |
| <b>Përzgjedhja e perfitueseve të granteve</b>  | 30.09.2021 | 10.10.2021 | BCK / Komuna e Podujevës |
| <b>Organizimi i një ceremonie shpërndarëse të granteve dhe certifikatave të pjesëmarrjes në trajnime</b> | 11.10.2021 | 11.10.2021 | BCK / Komuna e Podujevës |
| <b>Mentorimi/ Shërbime konsulente për biznese përfituese</b>   | 10.10.2021 | 30.10.2021 | BCK                      |
| <b>Promovimi në media</b>  | 10.10.2021 | 30.11.2021 | BCK / Komuna e Podujevës |
| <b>Përgatitja e raportit përfundimtar</b>  |            | 30.11.2021 | BCK / Komuna e Podujevës |

### III. Aneks

3.1. Buxheti i planifikuar

3.2. Profili i BCK-së

3.3. Modeli i MoU'së (BCK – Komuna e Podujevës)